

**M I R A T O H E T  
SOTIRAQ FILO****KRYETAR I BASHKISË****Plani vjetor i auditimit 2023*****“Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë”*****• Zhvillimet aktuale të NjAB.**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Bashkisë Korçë për vitin aktual 2022 në planifikimin fillestar ka planifikuar 7 auditime, për 3 punonjës (drejtori dhe 2 auditues).

Për periudhën 9 mujore stafi i drejtorisë së AB të Bashkisë Korçë është angazhuar në 4 misione auditimi.

Gjatë 9 mujorit të vitit 2022, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Bashkisë Korçë është angazhuar në 4 misione auditimi, prej të cilave

- 1 angazhim përputhshmërie në drejtorinë e prokurimeve të bashkisë.
- 1 angazhim i kombinuar me tematikë për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve.
- 1 angazhim performance për shërbimin e varrimit.
- 1 angazhim i kombinuar (përputhshmërie+financiar) në Qendrën rezidenciale të zhvillimit.

Për periudhën në vazhdim pritet të realizohen edhe 2 angazhime përputhshmërie, në drejtorinë e financës për detyrimet e prapambetura dhe në Sektorin e integritetit europian për një projekt me fondet IPA.

Një nga fushat e Bashkisë, shërbimi Urban (angazhim performance), është zëvendësuar me Shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve (auditim përputhshmërie). Për këto arsye auditimi i performancës për fushën e Shërbimit urban, zëvendësohet me në fushën e Shërbimit të Mirëmbajtjes së varrezave Publike.

Ndërsa 1 fushë e bashkisë, për auditimin e performancës në fushën e Shërbimeve në njësi administrative e rajone, parashikuar në planin vjetor 2022 zhvendoset për tu audituar në vitet pasardhëse.

Argumentat për rishikimin e planit të auditimit për vitin 2022 janë miratuar nga kryetari i bashkisë në dt.03.10.2022 dhe janë dërguar në DHAB në MF me shkresën nr.8836 prot, dt.14.10.2022.

**• Prioritetet e auditimit për vitin 2023.**

- Plotësimi i strukturës me katër auditues (përfshi këtu dhe drejtorin)
- Ndryshimet në raportet e auditimit sipas urdhërit nr.4, dt.10.01.2020 të Ministres së financave
- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna.
- Zbatimi i rekomandimeve të adresuara nga vlerësimi i jashtëm i cilësisë të kryer nga DHAB në MFE, në dt.23.02.2021.
- Monitorimi i strukturës së AB, sigurimi i cilësisë së auditimit.
- Monitorimi i sistemit të raportimit të të dhënave për veprimtarinë e AB.
- Të sigurohet që puna do të kryhet në përputhje me objektivat e paracaktuara.

**• Objektivat kryesorë për vitin 2023.**

Auditimi i brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektiv synon të ndihmojë subjektet e audituara të bashkisë Korçë, të përmbushin objektivat e tyre. Ai bën vlerësime, jep opinionet dhe rekomandime objektive:

- për funksionimin dhe mjaftueshmërinë e sistemeve.

- për përputhjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore.
- për funksionimin e elementëve të kontrollit të brendshëm (ambientin e kontrollit, menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi).
- për të siguruar titullarin e subjektit të auditur se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet, efikasitet, sipas palnifikimit dhe qëllimit të miratimit në buxhetin e bashkisë.

AB ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshilla dhe informacion lidhur me veprimtaritë që ka vlerësuar. Duke asistuar të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, i jep menaxhimit të lartë vlerësime të operacioneve e veprimeve, këshillime të pavarura, konfidenciale.

Qëllimi i funksionimit të auditimit të brendshëm është të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të gjitha subjektet e audituara. Në mënyrë të detajuar AB ka për qëllim :

1. Informimin e menaxhimit të lartë të bashkisë mbi punën e bërë dhe dhënien e sigurisë objektive, që sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet në shkallë të përshtatshme brënda subjekteve të audituara.
2. Raportimin e gjetjeve dhe konkluzioneve për fushat e audituara.
3. Dhënien e rekomandimeve konstruktive që të ndihmojnë punën për përmirësimin e operacioneve dhe të ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat.
4. Dhënien e opinioneve përfunksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

#### • Programimi i llojit të angazhimeve.

Për vitin 2023 janë parashikuar 7 angazhime prej të cilave 1 angazhim për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin e mëparshëm, 5 angazhime janë parashikuar për 4 fusha të subjektit të bashkisë dhe 2 angazhime janë parashikuar për institucionet e vartësisë.

Nga këto 7 angazhime janë parashikuar 3 auditime përputhshmërie, 1 auditim performance dhe 3 auditime të kombinuara.

Parashikimi për vitin 2023 është mbështetur në zbatimin e Udhëzimit nr.42, dt.27.10.2020 të ministrit të MFE “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga AB në sektorin publik”, orientimet e DHAB-së në MFE për vlerësimin e sistemit të detyrimeve financiare të prapambetura dhe vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe operacioneve të menaxhimit të brendshëm në sektorin e Integritimit Europian për projektet me fonde IPA, duke parashikuar angazhime auditimi për këto fusha.

#### • Planifikimi i kostos për vitin 2023.

Pjesë e rëndësishme e Planit Vjetor është Planifikimi i kostove të auditimit dhe mbulimi i tyre. Ky proces na ka ndihmuar për të siguruar mbulimin me auditim të përshtatshëm të fushave me risk të lartë në subjektet që auditohen. Duke parashikuar kostot dhe alokimin e burimeve, shkëmbimi i informacionit dhe koordinimit të planeve të auditimit me KLSH ndihmon për mbulimin më të mirë dhe mënjanon mundësinë e dublimit apo të mbivendosjes së punës.

Në përcaktimin e kostove të auditimit, më konkretisht në planifikimin e kohës së punës, krahas kohës së nevojshme për punën audituese janë marrë parasysh edhe faktorët :

- a. Koha për mbikqyrje – e gjithë puna audituese është subjekt rishikimi nga drejtori për të siguruar cilësinë e punës.
- b. Koha për trajnim – është planifikuar një kohë e caktuar për trajnim për rritjen profesionale të AB.
- c. Koha për ndjekjen e rekomandimeve – është koha përtë verifikuar nëse menaxhimi ka vepruar në kohë për zbatimin e rekomandimeve.
- d. Koha rezervë – parashikohet për çështje të paparashikuara që mund të dalin gjatë vitit.
- e. Koha për menaxhim dhe administrim – e cila parashikon kryerjen e detyrave të veçanta të caktuara nga menaxhimi dhe punë administrative.

Në mënyrë të përmbledhur *kostot e auditimit* sipas elementëve kryesorë paraqiten :

1) Buxheti gjithësej (2+3+4)	3118 mijë lek
2) Paga dhe sigurime shoqërore	2953 mijë lek
3) Shpenzime Udhëtimi e dieta	90 mijë lek
4) Të tjera	75 mijë lek
5) Numuri i punonjësve	3 punonjës
6) Kosto për person (1/5)	<b>1039 mijë lek/për person</b>

• **Planifikimi i burimeve për vitin 2023.**

*Burimet e planifikuara* janë :

1. Koha maksimale e vlefshme	780 ditë (52 javë x 5 ditë x 3 persona)
2. Pushime vjetore	60 ditë (4 javë për person x 3 persona)
3. Ditë pushimi (Festa Zyrtare)	42 ditë (14 ditë për person x 3 persona)
4. Pushime për arësye shëndetsore	30 ditë (2 javë për person x 3 persona)
5. Angazhime në trajnime	45 ditë (15 ditë për person x 3 persona)
6. Angazhime në mbledhje/takime	12 ditë (1 ditë në cdo tremujor)
7. Rezerva të planifikuara	30 ditë (10 ditë për person x 3 persona)
<b>TOTALI</b>	<b>561 ditë                      187 ditë/person</b>

• **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim.**

Stafi i Drejtorisë së AB i Bashkisë Korçë ka qënë pjesë e trajnimit bazë profesional. Drejtore e drejtorisë ka ndjekur programin e trajnimit dhe certifikimit për nivelin e parë të kualifikimit dhe ka fituar që në vitin 2005, titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

Gjatë vitit 2022, dy auditueset e certifikuar janë nënshtruar edukimit të përditësuar, trajnimit të vijueshëm e të detyrueshëm, të programuar dhe menaxhuar nga Drejtoria e Harmonizimit të AB në Ministrinë e Financave.

Të dy auditet e njësisë kanë përfunduar kursin e certifikimit si Auditues i Brendshëm në sektorin publik dhe kanë fituar këtë titull. Një audituese e re e punësuar në vitin 2021 është në pritje të hapjes së procedurave për certifikim.

Një analizë e nevojave për trajnim të stafit auditues të bashkisë sipas temave, ju dërgohet në pasqyrën 4 bashkëngjitur materialit.

• **Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së angazhimeve të auditimit, nga audituesit e drejtorisë së AB të bashkisë Korçë, kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë nëpërmjet tre komponentëve:

- Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë;
- Vetëvlerësimi periodik;
- Reagimet e subjektit të audituar;

**Monitorimit të vazhdueshëm** të veprimtarisë së auditimit. Duke marrë parasysh se struktura e AB e bashkisë Korçë nuk ka nivele të ndërmjetme drejtimi dhe drejtuese e njësisë është pjesë e grupit të auditimit në cdo angazhim, monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë kryhet nga audituesit duke shkëmbyer fushat midis audituesve në përfundim të cdo angazhimi.

Gjithashtu në përfundim të çdo angazhimi, nga dy audituesit dhe nga drejtori plotësohen formatet përkatëse për rishikimin e cilësisë së punës, të cilat bëhen pjesë e dosjes së angazhimit. Formatet janë përgatitur dhe plotësohen për Operacionet që rishikohen dhe Komentet në lidhje me to.

**Vetëvlerësimi periodik** fokusohet në kriteret të përcaktuara të vlerësimit të cilësisë së performancës së njësisë dhe përputhshmërinë e tyre me standartet ndërkombëtare të AB. Formatet e vetëvlerësimit periodik bëhen pjesë e dosjes së Raportimit vjetor të Njesisë.

**Sondazheve të subjekteve të audituara.** Në përfundim të çdo angazhimi drejtori i drejtorisë së bashku me raportin përfundimtar të auditimit, dërgon në subjektin e audituar edhe një anketë për të marrë reagime në lidhje me angazhimin e kryer. Plotësimi i Feedback-ut nga subjekti i audituar, për çdo angazhim bëhet pjesë e dosjes së auditimit.

Për të tre komponentët e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë hartuar anekset përkatëse. Sipas rekomandimeve të dhëna nga Vlerësimi i jashtëm i cilësisë të kryer nga DNAB në MFE, është ripunuar Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë, i cili është miratuar nga kryetari i bashkisë me Urdhërin nr.376, dt.28.05.2021.

Një kopje e këtij Urdhëri bashkë me materialin dhe Anekset përkatëse i është dërguar për informacion Drejtorisë së Harmonizimit të AB në MF me shkresën nr.4378, dt.28.05.2021.

Bashkangjitur me Planin Vjetor janë anekset si më poshtë :

- **Anekset e Planit Vjetor**

- *Pasqyra 3 **Plani i angazhimeve të AB për vitin 2023** ( sipas Manualit të AB, kapitulli III)*
- *Pasqyra 4 **Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të drejtorisë së AB për vitin 2023** (sipas Manualit të AB, kapitulli III).*
- *Pasqyra 5 **Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të drejtorisë së AB për vitin 2023** (sipas Manualit të AB, kapitulli III).*

**DREJTORIA E AUDITIMIT BRENDSEHEM BASHKIA KORÇË**

**Drejtoreshë**

Athinulla TREBICKA